

8JH-1
R 22

ALBERT RAKIPI

**DITA
KA
ENRIN
TEND**

POEZI

81474
R22

ALBERT RAKIPI

DITA
KA
EMRIN
TËND

poezi

DIBLIOTIKA E QYELIPI
SHKURASTER
- NR. 51386

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Nënat e dëshmorëve

Ikin vitet dhe ju,
të mirat nëna të dëshmorëve,
rralloheni në podiumet e kuq
të 5 majeve,
të nëntorëve,

Po na ikni...

Ju kërkojnë nipër e mbesa.
Si t'u themi?... Ah, po. Ikën te partizanët.
Partizanëve t'u çojnë bukë,
një palë çorape të leshta.

Ju kërkojnë gazetarë e telekronistë,
ju thërrasin shtëpive.
S'ju gjejnë.
Po kurrë fjala juaj s'ka munguar në gazetë,
as zëri e syri në kronikat televizive.

Nëndal e dëshmorëve

Po na ikni...

Po si ndodhka kështu, moj të shtrenjta?!

Ju ikni...

e ne na duket e vërtetë

ajo që fëmijëve u thamë:

Kanë shkuar te partizanët

e prapë do kthehen...

Barrikada

E ngritën barrikadën
me gurë nga gurët e rrugicës sonë,
me karrocën e drunjte të hamallit të varfër,
me këngën e lirisë që na ziente në gjokse...
Ç'të vinim në barrikadë tjetër?
Erdhi dhe një murator
dhe supeve të saj hodhi pallton e vjetër...

Zogu i marsit

Vinte gjithmonë një zog i bukur
pranverës në strehën e shtëpisë.
Nga hapësira të kaltra ai zog këngëshumë
fluturonte e më ulej në sup të fëmijërisë.

Ditëve të para të marsit çdo vit
me dy-tri cicërima thoshte: Erdha!
E pas më ndiqte gjer në vjeshtë
kur ai nisej në shtegtime të reja.

Vinte në mars e ikte në vjeshtë
zogu i bukur i fëmijërisë sime.
Po unë e kërkoja në çdo stinë,
pas të më ndiqte në shtegtime.

Nuk di në ç'mars, në çfarë dite
erdhi e s'iku kurrë.

E pas më ndjek në hapësira drite
ky zog punëtor e këngëshumë.

Me mua është kur plugoj arën,
tokës së vlagët i gëzohet si unë.
Me mua është kur takoj të dashurën,
në rrugë të njohura a të pashkelura kurrë.

Është një zog i bukur në jetë,
zogu i ëndrrës emri i tij.

Është një zog që s'njeh vjeshtë.

Foleja e tij — te zemra jote, njeri!

Në autobusin e orës gjashtë

Në autobusin e orës gjashtë,
hipën minatorët e turnit të parë,
gjimnazistët e zhurmshëm me çanta në duar,
një grua pak e trishtuar me fëmijën në krahë,
një çift pleqsh që vështronin si dy të

dashuruar

dhe agronomi i sektorit të parë
që shkon të marrë taserën e kandidatit.

Në urbanin e orës gjashtë
pret të hipë edhe një njeri.

Në sy — një buzëqeshje tinzare,
në duar — njëzet copë fshesë.

(Ç'të bëjmë, vëllaçko, për të nxjerrë ndonjë
lek!)

Mos e merr këtë njeri, shofer!
Se minatorët do ta ndiejnë lodhjen dyfish
dhe gjimnazistët s'do të përqendrohen dot mbi
libra,

dhe kjo grua që çon fëmijën në spital
më shumë do të trishtohet, do t'i shtohet
dhimbja,
pleqtë gazmorë do të bëhen grindavecë,
fjalamanë
dhe agronomi gëzimin do ta ketë më të paktë!
Mos e merr këtë njeri, shofer!
Dita më e lodhshme do të jetë për ty,
timonin më të rëndë do ta kesh.
Mos e merr...
Në autobusin e orës gjashtë
hipën minatorë e gjimnazistë,
dhe pleqtë gazmorë, dhe agronomi i ri,
dhe fëmija i sëmurë, dhe gruaja pak e trishtë,
dhe mëngjesi i bukur i majit... dhe asnjeri!

Demetra¹⁾

Nuk di se ç'pamje ke pasur, Demetra,
në përfytyrimin e njerëzve te grekët e vjetër.
S'kam si ta di, por them se te kujtesa
e mijëvjeçarëve që ikën e bukur ke qenë
patjetër!

Ti ishe perëndeshë, (ti ishe një mit)
që rriteshe e zbukuroheshe në çdo brez të ri.
Po koha ime nga mijëvjeçarët të nxori,
të dha gjak edhe zemër, të bëri njeri!

Nuk di kush të thirri i pari Demetra,
«perëndeshë» kush të quajti në lashtësi;
di që koha ime tha: «Demetra është zemra,
thuaji zemrës ta lulëzojë tokën, njeri!»

1) Demetra — hyjneshë e tokës